



A.nr.2060/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.2060/2025, të datës 23.12.2025, të parashtruar nga ankuesi M.B, nga Prizreni, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.2060/2025, të datës 23.12.2025, të parashtruar nga ankuesi M.B.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, M.B (*në tekstin e mëtejme referuar ankuesi*), më datë 23.12.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8001/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018832, të shpallur sipas konkursit të datës 09.10.2025, nga Komuna e Prizrenit, për Grupin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, përkatësisht për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë për Bujqësi*”, Klasa Profesional 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit, më datë 19.01.2026, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet **për përfundim të procedimit administrativ** të filluar sipas ankesës A.nr.2060/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Prizrenit, më datë 09.10.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00018832, për Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, pozita “Zyrtar i Lartë për Bujqësi”, Klasa Profesional 1, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, ku afati për aplikim ka qenë nga data 10.10.2025 deri më 08.11.2025.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, të cilit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, përmes Njoftimit të datës 21.11.2025, i ka refuzuar aplikacionin e punësimit, me arsyetimin se me dokumentet e bashkëngjitura me rastin e aplikimit, nuk plotëson kriterin e përvojës së kërkuar, prej paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës si dhe ka theksuar se i njëjti ka bashkëngjitur kopjen e letërnjoftimit me afat të skaduar.

Ndërsa, sipas Njoftimit të datës 21.11.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, rezulton se fazën e verifikimit paraprak si kandidatë që kanë plotësuar kriteret e konkursit, e kanë kaluar gjithsejtë katër (4) kandidatë, ku prej tyre kandidatja A.SH, me gjithsejtë 81.8 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi (57.8 nga testi me shkrim dhe 24 nga intervista), sipas Listës Përfundimtare të Vlerësimit të Kandidatëve të Komisionit të Pranimit, të datës 19.12.2025, është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Bujqësi.

Ankuesi, ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pa të drejtë i është refuzuar aplikacioni i punësimit, dhe se refuzimi i aplikacionit të tij pa një vlerësim real të dokumentacionit të ngarkuar, përbënë shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe barazisë në procedurë administrative, rrjedhimisht pretendon se me këtë rast është shkelur neni 38 i Ligjit Nr.08/L197 për Zyrtarët Publik, neni 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i Rregullores (QRK) Nr.15/2023 dhe pika 5 e konkursit përkatës. Andaj, kërkon konstatimin e shkeljeve substanciale të dispozitave procedurale të këtij ligji dhe aktit nën ligjor të sapo theksuar, dhe rikthimin e konkursit me numër reference RN00018832 në fazën e verifikimit paraprak.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati N.D, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00018832, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Bujqësi, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Prizrenit, kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë të rekrutimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.35/2026, të datës 26.02.2026, ka aprovuar ankesën e datës 13.01.2026, ndërsa ka anuluar Njoftimin, e datës 19.12.2025, për kandidaten e suksesshme, të shpallur nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit lidhur me konkursin RN00018832, duke kthyer kështu çështjen në fazën e verifikimit paraprak tek NJMBNJ të Komunës së Prizrenit, me detyrimin që kjo e fundit të bëjë edhe një herë verifikimin e kandidatëve të cilët kanë aplikuar në këtë pozitë.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.2060/2025, të datës 23.12.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.35/2026, të datës 26.02.2026, rrjedhimisht duke qenë se procedura e rekrutimit me numër reference RN00018832 është kthyer në fazën e verifikimit paraprak, pretendim ky kryesor i ankuesit, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.***

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundojë procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.2060/2025, të datës 23.12.2025.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.2060/2025

Atdhe GASHI
BAJRAKTARI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.B;
- Komunës së Prizrenit (Kryetarit të Komunës, Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.